



Në mbështetje të nenit 10,16 , 58 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L - 040 , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës , nr.28 , nenit 12 dhe 22 të Rregullores së MF , nr.04 / 2017 mbi Kriteret , Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ - ve , nenit 17 të Rregullores komunale për Subevncione dhe Transfere, nr.12/236, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me zyrën e kryetarit të Komunës së Malishevës , bëjnë këtë :

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Ftohen Organizatat joqeveritare të komunës së Malishevës që janë aktive dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre në komunën e Malishevës në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit, se mund të aplikojnë me projektet e tyre për përkrahje financiare nga komuna e Malishevës për vitin 2023. Gjithashtu, ftohen edhe individët që të aplikojnë me projekte dhe programe në fushën e kulturës dhe rinisë.

Shuma financiare për thirrjen publike është 85.000.00 €

Mbështetja financiare do të ofrohet varësisht nga vlerësimi i projektit nga Komisioni dhe mundësitë buxhetore të komunës së Malishevës .

OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektpropozimet për organizimin e aktiviteteve:

Kulturore:

- Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshme kulturore;
- Organizimi i ngjarjeve me karakter bashkëpunimi për promovim të vlerave kulturore;
- Botime librash;
- Ekspozita artistike;
- Konkurse artistike (Arti pamor, letrar dhe muzikor);
- Shfaqje teatrale dhe programe kulturo-artistike;
- Promovimi trashëgimisë kulturore;
- Pjesëmarrje në festivale jashtë komunës;
- Panaire artizanale.

Rinore:

- Fuqizimi i OJQ-ve Rinore në Malishevë (seminare, trajnime, punëtori, shkëmbim përvojash, etj.);
- Edukim joformal (kurse për gjuhë të huaja; trajnime për hartimin, menaxhimin e projektit si dhe raportimin; trajnim për monitorimin e institucioneve publike, ligjërata të ndryshme)
- Dita e Rinisë;
- Festivali rinor tradicional;
- Ekspozita me artistë të rinjë
- Kampe Rinore
- Promovimi i rekreacionit në komunën e Malishevës;
- Promovimi dhe mbështetja e talentëve të rinj;
- Aktivitete rinore të përcjella me fushata vetedijesuese për trashëgiminë kulturore dhe natyrore;
- Promovimi i vullnetarizmit;

Sportive:

OJQ-të (Klubet Sportive) në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektet në lëmin e sportit si dhe sipas shpenzimeve të pranuar, si në vijim:

- Pagesa e referimit për ndeshjet zyrtare;
- Pagesa e transportit për ndeshje zyrtare;
- Pagesa e ushqimit për ndeshje zyrtare;
- Pagesa e regjistrimit dhe kuotizimit në federatën përkatëse;
- Pagesa për blerjen të rekuizitave sportive;
- Pagesa për ekipin mjekësore gjatë ndeshjeve zyrtare;
- Pagesa për asistimin e policisë gjatë ndeshjeve zyrtare.

OJQ-të (Klubet sportive, Shoqatat Sportive) mundë të aplikojnë me një projekt që të kontribuojnë në avancimin, afirmimin dhe zbulimin e talentëve të rinj në sport, në komunën e Malishevës.

Specifikacion:

- Klubet e futbollit- anëtarë të Superligës (2,000.00 € - 10,000.00 €);
- Klubet e futbollit- anëtarë të Ligës së Parë (1,000.00 € - 5,000.00 €);
- Klubet e futbollit- anëtarë të ligave të tjera (1,000.00 € - 3,000.00 €);
- Klubet e volejbollit- anëtarë të Superligës A dhe B (2,000.00 € – 5,000.00 €);
- Klubet e volejbollit- anëtarë të ligave të tjera (1,000.00 € – 3,000.00 €);
- Klubet e hendbollit- anëtarë të Superligës (2,000.00 € - 5,000.00 €);
- Klubet e hendbollit- anëtarë të Ligës së Parë (1,000.00 € – 3,000.00 €);
- Klubet e atletikës, notit (2,000.00 € - 6,000.00 €);
- Klubet e ping-pongut- anëtarë të Superligës (1.000.00 € - 3.000.00 €);
- Klubet e shahut, shenjëtarisë, alpine, sportet luftarake dhe klubet tjera (500.00 € - 3,000.00 €);
- Shkollat e Futbollit (500.00 € - 1.000.00 €).

Dokumentet e kërkuara për aplikim :

1. Projektpropozimi , përfshirë agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit;
2. Formulari i aplikacionit;
3. Dokumenti identifikues;
4. Certifikata e regjistrimit e OJQ-së;
7. Dëshmi se OJQ nuk ka obligime ndaj ATK - së (Vërtetim nga ATK);
8. Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit .
9. Raporti financiar i vitit paraprak, nëse OJQ ka qenë përfituese e thirrjes publike paraprake të shpallur nga komuna e Malishevës.

Mënyra e aplikimit:

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur. Brenda zarfit vendosen 2 kopje të të gjithë dokumentacionit origjinal. Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimit në objektin e komunës, në sportelin e qendrës për shërbime për qytetarët.

Formulari i aplikimit dhe formulari financiar mund të shkarkohet në webfaqen e komunës:

<https://kk.rks-gov.net/malisheve/>

Aplikacionet e dërguara pas mbylljes së afatit si dhe aplikacionet e pakompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.

Thirrja publike për aplikim hapet, më: 19.04.2023 dhe mbyllet më 09.05.2023 në orën 16:00.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: dkrs_malisheva@hotmail.com

Kryetari i Komunës së Malishevës

Ekrem Kasraji

